



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1088/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internew Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Prizren për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me shenjën ZL.Anr.1088/2017 e datës 19.10.2017, kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1.500.00 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga organizata BIRN dhe Internew Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datë 18.11.2017 në ora 9 e mbrëmjes kandidatja për anëtare e Kuvendit Komunal në Prizren, Drita Millaku, nga radhët e subjektit politik LVV ka shpërndarë një fotografi me kandidatin e Vetëvendosjes për kryetar të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka me përshkrimin “ Buzëqeshja vazhdon edhe për 4 vitet e ardhshme”. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë veprim ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, subjekti politik LVV lidhur me pretendimet e BIRN në ankesën ndaj kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal Prizren të subjektit politik LVV për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore duke shpërndarë fotografinë me kandidatin e tyre për kryetar komune në Prizren, Mytaher Haskuka, informon PZAP-në se fotografia dhe mbishkrimi i cili thekson “ Buzëqeshja edhe për 4 vite të ardhshme” ka konotacion tepër të përgjithshëm dhe mund të interpretohet në mënyra të ndryshme dhe

asesi nga kjo fjali nuk mund të konstatohet ndonjë shkelje të heshtjes zgjedhore. Në vazhdim të përgjigjes subjekti politik LVV thekson se përveç fotografisë nuk shihet asnjë llogo apo numër të subjektit politik LVV e cila do ta kishte thyer heshtjen zgjedhore të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Më tej ka kërkuar që ankesa e ankuesit të Refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se kandidatja për anëtare e Kuvendit Komunal Prizren, Drita Millaku nga radhët e subjektit politik LVV ka shpërndarë një fotografi me kandidatin për Kryetar të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, në rrjetin e saj social Facebook, në të cilin shihet se ka përmbajtje të fushatës zgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore konkretisht me datë 18.11.2017 rreth orës 09:08 minuta PM, veprim ky që është në kundërshtim dhe me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Pretendimet e subjektit politik LVV se fotografia dhe mbishkrimin i publikuar në rrjetin social facebook, nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren, Drita Millaku nuk nënkupton shkelje të heshtjes zgjedhore pasi që në fotografinë shpërndarë në facebook nuk shihet asnjë llogo apo numër të Lëvizjes së Vetëvendosjes e cila do ta kishte thyerjen e heshtjes, këto pretendime nuk janë të bazuara për faktin se fotografia e shpërndarë në facebook nga anëtarja e Kuvendit Komunal Prizren Drita Millaku me kandidatin për Kryetar Komune të të njëjtit subjekt politik Mytaher Haskuka me mbishkrimin “Buzëqeshja edhe për 4 vitet e ardhshme”, paraqet promovim të kandidatit gjatë kohëzgjatjes së heshtjes zgjedhore.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së LVV-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 32 pika 3,4 dhe 5 dhe 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.1088/2017 më datën 21.11.2017



**Kryesuesja e Panelit  
Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.